



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 198/1 Prot.

Tiranë, më 05 . 02 . 2025

V E N D I M

Nr. 29 , datë 05 . 02 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 19 Regj., datë 27.01.2025, të shtetasit Z. Gj, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga bashkëshortja, znj. M. Gj, kundër Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹” dhe “aftësisë së kufizuar” të tij.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga znj. M. Gj, evidentohet problematika e lindur me subjektin për të cilin pretendon se e ka diskriminuar, Drejtorinë Vendore Tirana Rurale 2, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, (DV ASHK, Tirana Rurale 2), për të cilën, ndër të tjera, shprehet se:

“Kam një familje prej 5 (pesë) anëtarësh. Bashkëshorti im Z. Gj për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, prej vitesh nuk është në gjendje për të lëvizur pasi ka statusin e invalidit paraplegjik-tetraplegjik dhe për këtë arsye nuk ka patur mundësi për të ndjekur çështjet e tij. Sipas vetëdeklarimit për legalizim objekti nr. 689, datë 10.11.2006, kemi aplikuar për legalizimin e objektit shtëpi banimi, me adresë “Rruga e Durrësit”, pranë Servis Morini, ndërtuar në vitin 1995.

Në vitin 2006 kemi filluar procedurën e legalizimit dhe në vitin 2009, sipas VKM nr. 677, datë 18.06.2009, është miratuar kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore në favor të poseduesit të objektit informal. Konkretisht në fletën nr. 4585, me nr. 158, janë përshkruar të dhënat e pasurisë me nr. prot., Vetëdeklarimi nr. 689.

¹ Pa provuar apo dokumentuar se çfarë pretendon a shpjegon ankuesi me këtë shkak.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Kemi kërkuar vazhdimisht nga ish-ALUIZNI, dhe në vijim ASHK, të njihemi me ecurinë e legalizimit informal si më sipër, dhe nuk na është dhënë përgjigje. Pas shumë kërtimeve, me datë 06.12.2023, nëpërmjet shërbimit postar jemi vënë në dijeni se ka dalë një urdhër për pezullimin e procedurave të legalizimit.

Me datë 19.03.2024 më është vënë në dispozicion Urdhri nr. 37, datë 31.01.2022 “Për pezullimin e procedurave të ndërtimit informal pa leje, vetëdeklaruar me nr. 689, datë 10.11.2006 nga z. Z. Gj”.

Shkaku i ankimit tim është se, konkretisht, banesat e tjera pranë shtëpisë time, ndonëse ishin të parashikuara edhe ata ashtu si ne, në VKM nr. 677, datë 18.06.2009, janë legalizuar, ndërsa banesa jonë nuk është legalizuar. Ky është një diskriminim pasi është një trajtim i pabarabartë midis të barabartëve, siç është rasti i legalizimit për të tjerët, ndërsa për ne jo.

Duke marrë shkas nga gjendja shëndetësore e bashkëshortit tim, shteti duhet të kishte një trajtim më të madh krahasimisht me të tjerët, lidhur me ndjekjen e procedurave, ndonëse janë ndjekur të gjitha procedurat e rregullta dhe nuk ka pasur asnjë mangësi nga ana jonë për plotësimin e dokumentacionit për marrjen e shërbimit të kërkuar.”

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri: “Të konstatojë diskriminimin e familjes tonë dhe ASHK të zbatojë VKM nr. 677, datë 18.06.2009, me të cilën është miratuar kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore në favor të poseduesit të objektit informal, konkretisht në emër të bashkëshortit tim Z. Gj”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga këqyrja e analizimi i parashtrimeve dhe dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezultoi se:

- Sipas Vetëdeklarimit për legalizimin e objektit me nr. 689, datë 10.11.2006, z. Z. Gj ka aplikuar për legalizimin e objektit shtëpi banimi, me adresë “Rruga e Durrësit”, pranë Servis Morini, ndërtuar në vitin 1995.
- Me VKM nr. 677, datë 18.06.2009 “Për miratimin e kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale...” është miratuar kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore në favor të poseduesit të objektit informal. Specifikisht, me nr. rendor 158, të listës bashkëlidhur VKM-së sipërcituar, përshkruhen të dhënat për pasurinë me Vetëdeklarimin me nr. 689, pra që përkon me objektin informal banesë të z. Z. Gj.
- Subjekti ankues nëpërmjet kërkesave të përsëritura, ka kërkuar të njihet me ecurinë e procesit të legalizimit të banesës së tij, objekt informal.
- Me Urdhrin nr. 37, datë 31.01.2022 “Për pezullimin e procedurave të legalizimit të ndërtimit pa leje vetëdeklaruar me nr. prot., 689, datë 10.11.2006, nga z. Z. Gj”, të DV ASHK Tirana Rurale 2, është urdhëruar pezullimi i procedurave të legalizimit për ndërtimin pa leje sipërcituar.

- Nga përgjigjet e kthyer me datë 06.12.2023 dhe 19.03.2024, nga struktura përkatëse shtetërore/ ASHK, DV Tirana Rurale 2, subjekti ankues është informuar për pezullimin e procedurave të legalizimit të banesës së tij dhe arsyet përkatëse.
- Referuar shkresës me nr. 7497/4 prot., datë 01.12.2023, të ASHK-së, kjo e fundit ka informuar ankuesin se:

“Nga shqyrtimi i çështjes dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DV ASHK, Tirana Rurale 2, ka rezultuar se, objekti informal, aplikuar nga z. Z. Gj, me Vetëdeklarimin me nr. 689, datë 10.11.2006, Zk. 2679, referuar statusit juridik të nxjerrë nga regjistri i pasurive të paluajtshme rezulton se, ndodhet në truallin me nr. pasurie 440/136, vol. 14, fq. 231, në pronësi të bashkëpronarëve A. Pra, sipërfaqja e bazës së objektit që ju posedoni mbivendoset plotësisht mbi pasuri në pronësi të të tretëve.

Gjithashtu, referuar Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, atë 14.04.2017, rezulton se zona në të cilën pozicionohet ky objekt është parashikuar “Studim i lartë, mbi 7 kate”.

Sa më sipër, në kushtet që objekti informal i vetëdeklaruar nga z. Z. Gj, pozicionohet mbi pasuri me status 100% pronar, si dhe zona është zonë e studimit të lartë, ndodhemi në kushtet e nenit 29, të ligjit nr. 20/2020, sipas të cilit: “Objektet pa leje, sipërfaqja e bazës së të cilave shtrihet plotësisht mbi tokë private të të tretëve, ku dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit parashikojnë ndërtime mbi 6 kate nga niveli 0, nuk legalizohen”.

- Referuar Vendimit “Për caktimin e seancës përgatitore”, datë 01.02.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se, z. Z. Gj, (përfaqësuar me prokurë nga bashkëshortja M. Gj), në cilësinë e paditësit, ka paditur ASHK DV Tirana Rurale 2, duke kërkuar:
“1. Shfuqizimin e Urdhrit nr. 37, datë 31.02.2022, të ASHK DV Tirana Rurale 2, duke detyruar palën e paditur të vijojë me procedurën e legalizimit të objektit me vetëdeklarim nr. 689, datë 10.11.2006.
2. Detyrimin e palës së paditur të lidhë kontratën e shitjes së pronës që lidhet me vetëdeklarimin për legalizim të objektit me vetëdeklarim nr. 689, datë 10.11.2006, sipas VKM nr. 677, datë 18.06.2009”; kërkim të cilin ka parashtruar edhe pranë KMD-së.

Sa i takon pretendimit të palës ankuese, se është diskriminuar nga ana e ASHK-së, Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues³:

Së pari, subjekti ankues ka cilësuar vetëm që është diskriminuar nga ana e, ASHK DV Tirana Rurale 2, pa parashtruar apo sqaruar rrethana me fakte e prova se si ajo dhe bashkëshorti i saj, si kërkues, janë trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 2, apo se si ky trajtim lidhet me shkaqet e pretenduara prej saj.

³ Për anaogji citojmë vendimin nr. 107, datë 20.06.2023, të KMD-së.

Së dyti, sa i takon pretendimit për diskriminim duke shënuar tek formulari i ankesës “çdo shkak tjetër”, subjekti ankues, konsideron si trajtim diskriminues nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 2, faktin se familja e tyre është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me familjet e tjera që i kanë banesat afër tyre, pa dhënë ndonjë shpjegim apo fakte e prova se ky trajtim bazohet në ndonjë karakteristikë, apo cilësi të veçantë të tyre, bazuar mbi të cilën të prezumohej trajtimi i tyre i pafavorshëm e i pabarabartë. Subjekti ankues ka shënuar “çdo shkak tjetër” tek lista e shkaqeve në formularin e ankesës të KMD-së, pa shpjeguar e argumentuar atë.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe të mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë, të padrejtë e të pafavorshëm të tij nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 2, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur nga LMD.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh⁴. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁵.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”*⁶

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së

⁴ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁵ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

⁶ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë. Komisioneri vlerëson se, diskriminimi⁷ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Pala ankuese nuk provon me fakte e prova se mbart shkaqet e pretenduara, sipas përcaktimeve të LMD-së. Në kuptim të LMD-së, “*Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri*.”⁸.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

⁷ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

⁸ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Kjo pasi, ankuesi nuk ka arritur të provojë apo dokumentojë se çfarë konsideron me “çdo shkak tjetër”, pra se cila është karakteristika e tij individuale, bazuar mbi të cilën DV ASHK Tirana Rurale 2, e ka trajtuar në mënyrë të diferencuar.

Në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosegzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Pala ankuese nuk parashtroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucionit përgjegjës që të jenë motivuar nga shkak i pretenduar, pasi *vetë shkak* nuk është i provuar prej tij.

Vetëm pasi ankuesi të provonte para KMD-së se mbart e posedon shkakun e pretenduar, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e institucionit përkatës.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”⁹, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

⁹ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, të KMD-së, Vendimi nr. 27, datë 23.01.2024, etj.

Komisioneri të njëjtin qëndrim mban edhe për shkakun tjetër të pretenduar nga pala ankuese, që është aftësia e kufizuar e z. Z. Gj (aplikuesit për legalizimin e banesës ndërtim informal), pasi:

- Së pari, pala ankuese, lidhur me pretendimin për trajtimin e rastit të tyre nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 2, shprehet se: *“...nisur nga gjendja shëndetësore e bashkëshortit tim, shteti duhet të kishte një trajtim ndryshe në krahasim me të tjerët, lidhur me rastin e ndjekjes së procedurave, ndonëse janë ndjekur të gjitha procedurat e rregullta dhe se nuk ka pasur asnjë mangësi nga ana jonë për plotësimin e dokumentacionit për marrjen e shërbimit të kërkuar”*. Në këtë kontekst, Komisioneri sa më sipër vlerëson se, vetë pala ankuese, gjendjen shëndetësore të bashkëshortit (AK) e lidh me pamundësinë fizike të tij për ndjekjen e procedurave vijuese për finalizimin e legalizimit të banesës së tyre informale dhe jo me faktin që kjo AK ka shërbyer si motivacion për moslegalizimin e saj. Komisioneri gjen kontradiktore gjithashtu, pretendimin se gjendja shëndetësore e bashkëshortit të ankueses është bërë pengesë, pasi ajo pohon se pavarësisht këtij fakti nga ana tyre janë ndjekur të gjitha procedurat e rregullta dhe kanë plotësuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e këtij shërbimi. Znj. Gj është e pajisur me Prokurë të Posaçme nga ana e bashkëshortit për përfaqësimin, nënshkrimin dhe kryerjen e çdo veprimi të nevojshëm në emër të tij, para çdo organi administrativ, që ka lidhje me ndjekjen dhe përfundimin e procedurave të legalizimit të ndërtimit informal të banesës së tyre, deri në përfundimin e të gjitha procedurave. Pra, ajo nuk ka patur asnjë pengesë ligjore dhe faktike lidhur me ndjekjen e procedurave për legalizimin e banesës së tyre, ndërtim informal; fakt ky të cilin e pohon dhe vetë, kur deklaron se pavarësisht gjendjes shëndetësore të bashkëshortit, ata kanë ndjekur të gjitha procedurat e kërkuara dhe kanë plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm lidhur me këtë proces.
- Së dyti, nuk ka një parashikim ligjor i cili parashikon ndonjë lehtësi për kategorinë e personave me AK, të cilët janë në proces legalizimi të banesave të tyre, ndërtime informale dhe i cili të jetë shkelur apo të mos jetë zbatuar nga ana e institucionit përgjegjës, DV ASHK Tirana Rurale 2, në këtë rast.
- Për më tepër, pavarësisht sa më sipër, në asnjë rast nuk është dokumentuar apo dhe shprehur nga ana e palës ankuese (përveçse në ankesën pranë KMD-së) se institucioni përgjegjës, DV ASHK Tirana Rurale 2, ishte venë në dijeni prej tyre të faktit se aplikuesi z. Z. Gj, ishte person me AK.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, si dhe parashtrimet e palës ankuese, Komisioneri vlerëson se, znj. Gj ka ngritur pretendime për diferencë në trajtim ose për dështimin nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 2, për të trajtuar ndryshe rastin e kësaj familjeje, situatë e cila supozohet se ka si shkak “çdo shkak tjetër” pa shpjeguar se çfarë nënkupton pala ankuese me të dhe gjendjen shëndetësore (AK) e z. Z. Gj, si përfitues i statusit të invalidit¹⁰ (paraplegjik-tetraplegjik). Këtë të fundit e lidh me pretendimin për pengesën e z. Gj për shkak të AK, për të ndjekur fizikisht procedurat për legalizimin e banesës së tij, dhe jo me faktin që AK në vetvete ka shërbyer si shkak për moslegalizimin e banesës së tyre, objekt informal.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë AK e bashkëshortit të ankuses dhe “çdo shkak tjetër” pa shpjeguar dhe provuar se çfarë përfshin ajo tek ky shkak.

Pala ankuese nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucioneve përgjegjëse që të jenë motivuar nga shkaqet sipërcituar.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹¹, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga pala ankuese kundër ASHK DV Tirana Rurale 2, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri evidenton faktin se, pala ankuese, të gjitha pretendimet që burojnë nga veprimet apo sjellja e DV ASHK Tirana Rurale 2, lidhur me pezullimin e procedurave të legalizimit të ndërtimit pa leje, objektit banesë të saj dhe moslegalizimin e saj, janë pretendime që lidhen me paligjshmërinë e prezumuar nga DV ASHK Tirana Rurale 2, kundrejt saj. Kërkime këto që subjekti ankues i ka ngritur dhe po i ndjek gjyqësisht, sipas objektit të ngritur në kërkesë-padinë para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku ndër të tjera, ka kërkuar:

“- Shfuqizimin e Urdhrit nr. 37, datë 31.02.2022, të ASHK DV Tirana Rurale 2, duke detyruar palën e paditur të vijojë me procedurën e legalizimit të objektit me vetëdeklarim nr. 689, datë 10.11.2006.

¹⁰ Referuar Librezës përkatëse me nr. 12699, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, me afat vlefshmërie nga data 01.11.2022 deri më datë 01.11.2025.

¹¹ Neni 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcakton se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”.

- Detyrimin e palës së paditur të lidhë kontratën e shitjes së pronës që lidhet me vetëdeklarimin për legalizim të objektit me vetëdeklarim nr. 689, datë 10.11.2006, sipas VKM nr. 677, datë 18.06.2009”, dhe se, në mungesë të lidhjes me shkaqet e cituara ato mbeten thjesht pretendime në kuadër të paligjshmërisë së tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, z. Z. Gj, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA